



Platforma

për t'i kthyer dinjtëtin Universitetit të Tiranës

- KOLEGJIALITET
- NDËRKOMBËTARIZIM
- TRANSPARENCË

BIO

Prof. Dr. Artan Hoxha është lindur më 18.07.1960 në qytetin e Tiranës. Ai është diplomuar për Drejtësi në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në vitin 1983. Në periudhën 1994 - 1995 ka kryer studime pasuniversitare në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Leiden-it në Holandë, në fushën penale për Konventat e Këshillit të Evropës. Në Tetor 2009 ka fituar gradën shkencore “Doktor” në “Të drejtë penale”. Në Dhjetor 2012 ka marrë titullin akademik “Profesor i Asociuar”, ndërsa në Shkurt 2015 ka fituar titullit akademik “Profesor”.

Prof. Hoxha e ka filluar karrierën e tij profesionale si Prokuror Sektori në Prokurorinë e Rrethit Lushnje (1983 - 1987) dhe më pas është emëruar Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme (1987 - 1991). Gjatë periudhës 1992 - 1994, ka kryer detyrën si specialist, e më tej në vitet 1997 - 1999 si Drejtor i Drejtorisë së Kodifikimit pranë Ministrisë së Drejtësisë. Për periudhën 1999 - 2008, ka shërbyer për një mandat të plotë 9-vjeçar si Gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, në vitet 2008 - 2016 ka mbajtur detyrën e Drejtorit pranë Drejtorisë Juridike të UT-së. Nga viti 2016, Prof. Dr.



Artan Hoxha është Dekan i Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës.

Që prej themelimit të Shkollës së Magjistraturës në vitin 1997, është angazhuar si pedagog dhe ekspert për formimin fillestar dhe atë vazhdues për gjyqtarë e prokurorë. Prof. Hoxha ka një eksperiencë të gjerë si lektor në disa prej universiteteve në vend, kërkues shkencor në Universitetin Hugo De Groot, Universiteti i Leiden-it (Leiden Law School) në Holandë, pjesëmarrje dhe kontribut profesional në konferenca kombëtare e ndërkombëtare. Ai është anëtar i këshillit të profesorëve për dhënien e gradës së PHD-së në Universita Degli Studi Firenze, si dhe autor i një sërë botimesh e artikujsh shkencorë. Ai është autor i disa monografive,

leksioneve, punimeve shkencore e profesionale si: “Komentari i Kodit të Procedurës Penale”, “Ekstradimi dhe Urdhri European i Ndalimit”, “Ekstradimi sipas Instrumenteve Ligjorë të BE-së”. Ngjashmëritë dhe Diferencat me Konventat e Këshillit të Evropës”, “L’integrazione dell’Albania nell’UE”, Udhëzuesin për gjyqtarët “Mbi normat standarde të trajtimit të fëmijëve në sistemin e drejtësisë”, Komentarin e ligjit “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, Ligjërata mbi Reformën në Drejtësi, etj.

Krahas karrierës akademike, Prof. Hoxha ka kontribuar në mënyrë aktive në një sërë angazhimesh e funksionesh të tjera si: Anëtar i Asamblesë së Komitetit Shqiptar të Helsinkit; Anëtar i Këshillit Konsultativ pranë Avokaturës së Shtetit, Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, Anëtar i Komisionit për Çështje Sociale pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, anëtar i Këshillit Shkencor të Serisë së Botimeve “Itinerare Studimesh

Juridike, Ekonomiko-Politike dhe Sociale”. Për shumë vite ka dhënë kontribut në veprimtari të shoqërisë civile dhe pjesëmarrje në disa organizata jofitimprurëse.

Ai ka kontribut të veçantë në reformimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, duke qenë pjesëmarrës i çdo reforme kryesore të ndërmarrë në sistemin e drejtësisë, që prej ndryshimit të sistemit politik në vendin tonë e deri më sot. Po ashtu, Prof. Hoxha është angazhuar në hartimin e një sërë projektligjesh dhe akte normative me impakt të veçantë në fushën e drejtësisë dhe më gjerë. Në vitin 2006 është dekoruar nga Presidenti i Republikës me Medalje “Për merita të veçanta civile” me motivacionin “Për kontribut të shquar në hartimin e legjislacionit të ri në fushën e drejtësisë, angazhimin dhe përkushtimin profesional e moral në ushtrimin e funksionit të anëtarit të Gjykatës së Lartë”. Prof. Dr. Artan Hoxha është anëtar nderi në John Marshall Law School, Chikago, SHBA si dhe është anëtar në borde të ndryshme editoriale në revista shkencore.

Të dashur pedagogë dhe studentë të Universitetit të Tiranës,

Të jem sot para jush si kandidat për Rektor i Universitetit të Tiranës, është nder dhe përgjegjësi tepër e madhe. Ky vendim ka ardhur si rezultat i një procesi të gjatë reflektimi dhe me dëshirën për të kontribuar në transformimin e universitetit më të madh në vend, UT- së, në një universitet elitar dhe që ofron ekselencë në çdo fushë të veprimtarisë së tij.

Të gjithë kemi qenë dëshmitarë të një periudhe të vështirë që institucioni ynë ka kaluar si pasojë e problematikave dhe konflikteve të brendshme, që fatkeqësisht nuk i kanë hije Universitetit të Tiranës, i cili është dalluar gjithmonë për rolin e tij të padiskutueshëm në mbrojtje dhe përparimin e arsimit të lartë në vend. Gjatë këtyre 4 viteve, UT ka dalë jashtë kornizave të institucionalizimit, ku problemi kryesor ka qenë sfida e hapur që i është bërë zbatimit të ligjit dhe respektimit të autonomisë së brendshme akademike dhe funksionale. Pikërisht kjo sjellje e paprecedentë solli edhe një nismë të pa hasur më pare, atë të kërkesës për shkarkimin nga detyra të rektorit të universitetit.

*Unë besoj fort se bazat më të forta e më të shëndosha për të ringritur në këmbë shtëpinë më të madhe të arsimit të lartë në vend, që është shtëpia jonë e përbashkët janë: **Kolegjialiteti, Ndërkombëtarizimi dhe Transparenca.** Mbi këto tre shtylla është mbështetur edhe platforma që ju ofroj, për të cilën mbetem i hapur të përfshij kontributet dhe sugjerimet tuaja gjatë takimeve të drejtpërdrejta si edhe në rrugë elektronike.*

Të nderuar kolegë, bashkë kemi kaluar sfida të shumta. Këto sfida na kanë bashkuar e na kanë bërë më të fortë. JU, me punën dhe përkushtimin tuaj jeni aset i vyer i institucionit tonë, i cili së bashku me studentët që për fatin tonë janë edhe më cilësorët në vend, krijon mundësi të pafundme për zhvillim dhe përsosje të veprimtarisë së universitetit. Komunikimi dhe bashkëpunimi mes nesh, forcimi i zërit tuaj në vendimmarrjet kolegjiale, respektimi i autonomisë së brendshme dhe krijimi i kushteve për rritjen dhe zhvillimin tuaj profesional, do jenë ato që do drejtojnë punën time në interes të së mirës sonë të përbashkët. Ne do të përdorim çdo hapësirë të ofruar nga korniza ligjore dhe aktet tona rregullative për të mbrojtur dinjitetin dhe krijimin e kushteve optimale për zhvillimin e mëtejshëm të Universitetit të Tiranës në realizimin e misionit të tij.

KOLEGJALITET • NDËRKOMBËTARIZIM • TRANSPARENÇË

për t'i kthyer dinjitetin Universitetit të Tiranës

Të dashur studentë, me zgjedhjen për të studiuar në UT, na keni besuar të ardhmen tuaj, ndaj përballë jush kemi detyra e përgjegjësi të mëdha që duhen përmbushur. Protestat tuaja ishin treguesi më i mirë i problematikave, por njëkohësisht edhe i zgjidhjeve të tyre nëpërmjet bashkëqeverisjes së UT-së me ju në vitet në vazhdim. Momenti i zgjedhjeve është një moment i rëndësishëm, pasi ju lejon në mënyrë të drejtpërdrejtë të vendosni për përfaqësuesit tuaj. Unë, si njëri prej tyre, angazhohem që ta përçoj më së miri misionin që do më besoni.

Në cilësinë e Rektorit të UT do punoj fort për rikthimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e UT, me vendosjen e një fryme të thellë bashkëpunimi e koherence në të gjitha strukturat dhe forcimin e vendimmarrjeve të organeve kolegjiale. UT duhet të rikthehet në zërin e fuqishëm të politikave universitare jo vetëm në Shqipëri, por në mbarë hapësirën shqipfolësve për t'iu përgjigjur më së miri sfidave globale.

Të dashur studentë,

Të nderuar kolegë,

Sot para jush, nuk paraqes premtime, por një platformë konkrete, reale dhe të mundshme për t'u realizuar. Sot ju kërkoj t'i bashkoheni këtij rrugëtimi, për t'i kthyer Universitetit të Tiranës krenarinë, dinjitetin dhe vendin që i takon.

PERSONELI AKADEMIK

Personeli akademik përbën asetin dhe potencialin më të rëndësishëm të UT-së. Ata janë dëshmitarë të shumë proceseve dhe sfidave transformuese të tij. Ky mandat do të shërbejë për të realizuar hapa mbështetës konkret ndaj personelit akademik duke krijuar hapësirat e nevojshme për përmirësimin e statusit të tyre profesional dhe financiar. Më konkretisht kjo mbështetje do të fokusohet në:



✓ *Modelin e bashkëpunimit efektiv, transparent dhe kolegjal* me organet drejtuese si Rektorati, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të UT, duke eliminuar çdo model përjashtues. Bashkëpunimi mes strukturave të UT-së do të mundësojë koordinimin e politikave në mbështetje të personelit akademik të UT-së.

✓ *Hartimin dhe miratimin e menjëhershëm të të gjithë kuadrit rregullator të funksionimit të UT-së.* Nëpërmjet bashkëpunimit efektiv të Rektorit, Rektoratit, Dekanateve dhe Njësiëve bazë, veprimtaria administrative do të kthehet në

funksion të veprimtarisë mësimore dhe kërkimit shkencor, duke shmangur çdo paqartësi apo keqinterpretim në zbatimin e kompetencave sipas LAL, statutit dhe rregullores së re të UT-së.

✓ *Ofrimin për herë të parë të mbështetjes financiare për rritjen profesionale, të personelit akademik* duke:

1. Shfrytëzuar të gjitha hapësirat që jep Ligji i Arsimit të Lartë për rishikimin e pagës së personelit akademik;
2. Krijuar mundësitë për të mbuluar financiarisht përgjatë vitit akademik, një pjesëmarrje referuese në veprimtari shkencore ndërkombëtare (kongres, simpozium, konferenca etj.), organizuar në një nga vendet e BE, OECD ose G-20 dhe të pranuar me vlerësim paraprak shkencor të botuar në “Proceedings” dhe indeksuar me kod ISBN ose ISSN;

3. Krijuar mundësitë për të mbuluar financiarisht përgjatë vitit akademik, fee-në për botimin e një artikulli shkencor në një revistë ndërkombëtare me Factor Impakti ose Scopus. Skemat e mbështetjes financiare për mbulimin e fee-ve do të realizohet në bazë të një procedure të formalizuar



- dhe standardizuar në nivel institucional, procedurë e munguar deri tani në UT;
4. Aplikuar politika mbështetëse financiare ndaj kategorisë 'profesor' në UT për të mundësuar rritjen e studimeve e kërkimeve shkencore dhe evidentimin e profesoratit si aset i fuqishëm për të ndihmuar në zgjidhjen e problematikave që shfaqen në zhvillimin e shkencës dhe ekonomisë së vendit;
5. Angazhuar personelin akademik në projekte ndërkombëtare që rrisin vizibilitetin e UT-së në arenën ndërkombëtare, të cilët do të shpërblehen në formën e honorarëve sipas përcaktimeve në marrëveshjen e grantit të fituar.



✓ *Lehtësimin e procedurave për menaxhimin e projekteve.*

Eliminimi i burokracive do të sjellë lehtësimin e procedurave në menaxhimin e projekteve të BE-së dhe me donatorë të huaj. Kjo do të kërkojë edhe delegimin e kompetencave për aplikimin dhe menaxhimin e projekteve kërkimore e shkencore, nga

fakultetet dhe njësitë bazë të UT-së. Delegimi i kompetencave te njësia bazë do mbështesë personelin akademik të UT-së për të aplikuar dhe menaxhuar në mënyrë të pavarur projektet e fituara nga programe kombëtare e ndërkombëtare të BE-së e më gjerë.

KOLEGJIALITET • NDËRKOMBËTARIZIM • TRANSPARENÇË

për t'i kthyer dinjitetin Universitetit të Tiranës

- ✓ Në përputhje me fushat e studimit në nivel njësie bazë dhe njësie kryesore, do të mundësohet **abonimi në revista shkencore ndërkombëtare** duke lehtësuar punën kërkimore shkencore të tyre.
- ✓ Inicimin e rihapjes brenda Universitetit të Tiranës të ***Shtëpisë Botuese të Librit Universitar***. Kjo është një strukturë e domosdoshme për rritjen e mundësive botuese të librit universitar, me impakt edhe në rritjen e numrit të përkthimeve të teksteve mësimore thelbësore në ndihmë të mësimdhënies në UT dhe zbutjes së problematikave të personelit akademik.
- ✓ Mbështetje maksimale për zhvillimin profesional dhe akademik të stafit duke **inkurajuar dhe lehtësuar procedurat e mobilitetit të personelit** jo vetëm në kuadër të mobiliteteve akademike por edhe drejt sektorit privat. Delegimi direkt te fakultetet dhe njësitë bazë, si strukturat më të specializuara nga ana profesionale, për të kryer procesin e përzgjedhjes së aplikantëve fitues në programet Erasmus. Ky proces do eliminojë praktikën e deritanishme selektive, përjashtuese dhe jo transparente të ndjekur. Rektorati do të mbajë në të ardhmen vetëm funksione mbështetëse, koordinuese dhe lehtësuese.



Erasmus+



Interreg - IPA CBC



EUROPEAN UNION

PERSONELI NDIHMËS AKADEMIK DHE STAFI ADMINISTRATIV

Mbështetja institucionale për personelin ndihmës akademik dhe stafin administrativ do të ndikojë në rritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve për studentët dhe aktorët e tjerë në UT. Mbështetja institucionale në ndihmë të personelit ndihmës akademik me karakter administrativ apo mësimor do të fokusohet në:

- ✓ Strukturimin e organigramës së stafit ndihmës dhe administrativ në UT duke mbështetur personelin si në rritjen e shkallës së kategorizimit të pozicionit të punës që shoqërohet me shpërblim më të lartë financiar ashtu dhe në rritjen e cilësisë së dhënies së shërbimeve nga personeli për studentët, praktika këto që deri tani përqendroheshin në Rektoratin e UT.
- ✓ Rritjen e mundësive për personelin ndihmës akademik me karakter administrativ apo mësimor si dhe për stafin administrativ, për të aplikuar për fitimin e mobiliteteve trajnuese me qëllim rritjen e ekspertizës sipas profilit të punës që ky staf ka në njësitë përkatëse, duke ndihmuar në rritjen e tyre profesionale.
- ✓ Rritjen e personelit ndihmës akademik dhe stafit administrativ të njësive kryesore të UT-së. Kjo do të mundësojë funksionimin më të mirë të strukturave ndihmëse si Qendra e Karrierës, Alumni, Shërbimi psiko-social etj., hallka të rëndësishme për shërbim më të mirë ndaj studentëve dhe aktorëve të tjerë në fakultetet e UT-së.
- ✓ Konfirmimin dhe aplikimin, në mbështetje të LAL, të së drejtës për të marrë shpërblimin për punën e kryer jashtë orarit zyrtar, por të deleguar nga drejtuesit e njësisë kryesore për zbatimin e detyrave të përcaktuara në pozicionin e punës që kërkojnë orë shtesë ose kërkojnë angazhimin e tyre edhe në ditë festash apo pushimi.
- ✓ Funksionimin e menjëhershëm të sistemit digjital të UT-së. Funksionimi i plotë i sistemit digjital do ndihmojë personelin ndihmës akademik për të rritur efikasitetin e shërbimit në sajë të një koordinimi më efektiv dhe të shpejtë të punës së secilës strukturë me strukturat e tjera brenda UT-së.



KËRKIMI SHKENCOR

Kërkim shkencor me një impakt të drejtpërdrejtë në ekonomi dhe shoqëri do të jetë një nga drejtimet kryesore në të cilat do të punohet fort gjatë këtij mandati. Në cilësinë e Rektorit të UT-së do të mbështes maksimalisht stafin akademik dhe kërkues të UT-së në këtë drejtim. Duke vendosur *prioritetet e duhura*, duke *siguruar fonde për kërkimin nga burime alternative* dhe duke qenë të vetëdijshëm *për implikimet etike dhe sociale të rezultateve kërkimore* brenda UT-së, jam i bindur që së bashku do t'i japim një zhvillim cilësor kërkimit me standarde bashkëkohore në universitetin tonë. Mbështetja e kërkimit shkencor do bazohet në:

- ✓ Krijimin e qendrave të dedikuara me infrastrukturën e duhur fizike dhe humane në zhvillimin e projekteve kërkimore në nivel institucional dhe njësie bazë nëpërmjet ***ngritjes së Qendrave të Kërkim-Zhvillimit (R&D)***. Përpos kërkimit në njësitë bazë do të stimulohet bashkëpunimi ndërdisiplinor në kërkim me përfshirjen e sa më shumë pjesëmarrësve më



qëllim krijimin e rrjeteve kërkimore me aktorë të ndryshëm lokal, rajonal dhe ndërkombëtar. Prioritet do t'i jepet bashkëpunimeve në projekte kërkimore ndërkombëtare me qëllim ngritjen e kapaciteteve fizike me teknologji dhe

pajisje të përparuara moderne dhe ofrimin e ekspertizës së nevojshme në fushën e kërkimit. Për këtë do të synohet rritja e aplikimeve për grante kërkimore të financuara nga organizata dhe institute ndërkombëtare kërkimore, duke përfutuar edhe nga eksperiencat e praktikat e mira.

- ✓ Inicimin e alokimit të një fondi financiar për mbështetjen e projekteve kërkimore shkencore duke angazhuar personel akademik, por edhe studentë doktorantë apo studentë të ciklit 'Master i Shkencave'.

- ✓ ***Ngritjen e Zyrës së Transferimit të Teknologjisë (TTO)***. Kjo zyrë do të shërbejë si një hallkë e rëndësishme në transformimin e produkteve kërkimore të UT-së në produkte me vlerë kryesisht për industrinë dhe për shoqërinë në tërësi. Zyra do të vlerësojë potencialin ekonomik të produktit kërkimor apo idesë / shpikjes dhe do të mbështesë hap pas hapi të gjithë proceset për daljen në treg me vlerë dhe impakt socio-ekonomik të produktit final. Kjo zyrë do të ofrojë asistencë edhe në procedurat dhe praktikatat e lidhura me pronësinë intelektuale dhe mbrojtjen e saj.
- ✓ ***Diversifikimin e portofolit financiar të UT-së***. Kjo do të mundësohet duke rritur bashkëpunimin në drejtim të kontratave kërkimore me institucione kërkimore ndërkombëtare dhe sektorin publik e privat dhe, implementimin e praktikës së ***kontratave doktorale***. Të ardhurat shtesë të gjeneruara nga këto kontrata që do të shkojnë në mbështetje të kërkimit shkencor të UT-së dhe në ofrimin e një produkti kërkimor me ndikim real në shoqëri dhe ekonomi.
- ✓ Krijimin për herë të parë në UT të ***procedurave financiare lehtësuese për thithjen dhe implementimin e të ardhurave që gjenerohen për kërkimin shkencor nga vetë njësitë kryesore të UT-së***. Rritja e financimit për kërkimin shkencor do të realizohet nëpërmjet gjenerimit të fondeve për kërkimin shkencor nga agjencitë e linjës, aplikimit me projekte konkurruese në fondacione dhe organizma kombëtarë e ndërkombëtarë, publikë e privatë, rritjes së investimit për kërkimin shkencor nga vetë buxhetet e fakulteteve, përfitimit nga bashkëpunimi me të tretët, nga donacione etj.
- ✓ Inicimin për herë të parë në UT të organizmit të një ***redaksie botuese*** në strukturën e Rektoratit dhe krijimit të Bordit Shkencor Botues, part-time me figura nga profesori i UT-së dhe nga universitete të huaja, për të mundësuar ***botimin e dy ose tri titujve të revistave shkencore periodike*** me peer review, open sources, online, etj., të indeksuara si revista shkencore në databaza ndërkombëtare. Revistat, me botimin e gjetjeve dhe studimeve didaktike e shkencore nga personeli akademik, studentët e UT-së e më gjerë, do të jenë pika referimi të mendimit shkencor kombëtar e më gjerë.

KOLEGJIALITET • NDËRKOMBËTARIZIM • TRANSPARENÇË

për t'i kthyer dinjitetin Universitetit të Tiranës

- ✓ *Rritjen e numrit të anëtarësimit të UT-së në rrjete evropiane akademike dhe kërkimore në mënyrë strategjike, duke synuar rritjen e numrit të partneriteteve dhe vizibilitetit të UT-së globalisht.*
- ✓ *Rritjen e fondit të financimit për laboratorët kërkimorë shkencorë, në shërbim të kërkimit dhe praktikave laboratorike.*



MËSIMDHËNIA

Mësimdhënia në UT është një nga shtyllat kryesore që e promovon atë si universitetin më elitare në vend. Rritja cilësore e procesit të mësimdhënies në UT do të realizohet duke mbështetur njëkohësisht rritjen profesionale të personelit akademik, duke rritur standardet e programeve të studimit si dhe duke përmirësuar vazhdimisht infrastrukturën fizike. Ndërhyrja për të mbështetur rritjen e standardeve të cilësisë së procesit të mësimdhënies në UT do të fokusohet në:

- ✓ **Mbështetjen në modernizimin e kurrikulave mësimore.** Do të punohet intensivisht drejt rritjes së bashkëpunimeve me fondacione të ndryshme që operojnë në Shqipëri, për të mundësuar mbështetjen e stafit me literaturë bashkëkohore profesionale dhe programe bashkëkohore të vlerësimit të njohurive të studentëve. Finalizimi i këtij procesi do të konsistojë fillimisht në zhvillimin dhe përditësimin e disa programeve mësimore e në vijim do të shtrihet përgjatë gjithë universitetit.
- ✓ **Përmirësimin e raportit student - pedagog.** Rritja organike e personelit akademik nëpërmjet rekrutimit të ekselencës akademike, të dalë nga universitetet shqiptare dhe universitetet e huaja do rregullojë raportin pedagog - student drejt normave bashkëkohore, duke përmirësuar standardet e cilësisë.
- ✓ **Hapjen e programeve të reja të studimit** bazuar mbi kërkesat e njësisive bazë. Këto programe mund të hapen edhe në bashkëpunim me institucione ndërkombëtare dhe institucione apo kompani lider publike e private që ofrojnë ekspertizë në fusha të caktuara. Bashkëpunimi midis stafeve universitare, hartuesve të programeve të reja dhe përfaqësuesve të këtyre organizmave, realizohet edhe nëpërmjet mbështetjes financiare për marrjen e eksperiencës më të mirë profesionale dhe sigurimin e literaturës më të mirë bashkëkohore në fushat e studimit të këtyre programeve.



- ✓ **Rritjen e numrit të programeve të përbashkëta ndërkombëtare** (ofrimi i diplomave të dyfishta dhe të përbashkëta) në sajë të bashkëpunimit me projekte të huaja apo marrëveshjeve bilaterale me partnerë strategjik lider në fusha të caktuara studimi. Kjo do të mundësojë edhe njohjen më të madhe në arenën ndërkombëtare të UT-së.



- ✓ **Hapjen e programeve të studimit në gjuhën angleze.** Programet e studimit në gjuhë të huaj do të ndihmojnë rritjen e cilësisë së mësimdhënies në UT duke e ndërkombëtarizuar këtë proces me studentë të huaj por dhe do gjenerojë të ardhura

nga thithja e studentëve të huaj që do të ndjekin këto programe studimi.

- ✓ **Rekrutimin e personelit akademik të ftuar dhe me kohë të pjesshme** në interes të njëjësive bazë të UT-së, duke synuar personalitete të njohura në fusha të ndryshme. Gjithashtu do synohet përfshirja e studiuesve dhe specialistëve të rinj që kanë përfunduar studimet me rezultate ekselente, brenda apo jashtë vendit.
- ✓ **Implementimin e Platformës digjitale** për mësimdhënien online. Kjo kërkesë është iniciuar edhe nga emergjenca për mësimin online që nxori në pah situata epidemike e COVID-19. Vendosija e Platformës digjitale do t'i shërbejë rritjes së procesit të mësimdhënies në UT, sepse do të mundësojë shkëmbimin online të informacioneve me universitetet homologe shqiptare dhe të huaja, përfshirjen e stafit shqiptar e të huaj në procesin e mësimdhënies në UT dhe në universitetet e huaja, do të lehtësojë organizimin e programeve të përbashkëta të studimit, do të transferojë informacione në kohë reale, do të mundësojë organizimin e kurseve online dhe do të lehtësojë studentët me aftësi fizike të kufizuara për të ndjekur më mirë mësimin përmes platformës online.
- ✓ **Përmirësimin e infrastrukturës së ambienteve ku zhvillohet procesi mësimor.** Do të shqyrtohen të gjitha mundësitë për përmirësimin e kushteve dhe zgjerimin e hapësirave të mësimdhënies, laboratorëve mësimorë dhe ambienteve rekreative për të përmbushur të

KOLEGJIALITET • NDËRKOMBËTARIZIM • TRANSPARENÇË

për t'i kthyer dinjitetin Universitetit të Tiranës

gjitha kërkesat që kanë programet e ndryshme të studimit në UT. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet krijimit të kushteve të duhura për studentët me aftësi ndryshe.

- ✓ ***Ngritjen dhe zhvillimin e inkubatorëve të biznesit.*** Universiteti duhet të luajë rolin e një inkubatori natyral që siguron një mjedis të përshtatshëm për të gjithë komunitetin e tij universitar (personel akademik, student dhe personelin ndihmës akademik) për të identifikuar, eksploruar dhe shfrytëzuar ide inovatore që gjenerohen brenda universitetit dhe që mund të transformohen në biznese të reja me impakt ekonomik dhe social për shoqërinë. Gjatë këtij 4-vjeçari do të ngrihen dhe zhvillohen struktura të dedikuara **të inkubatorëve të biznesit në UT**, që mbështesin dhe ndihmojnë personelin dhe studentët me ekspertizë në krijimin e bizneseve të reja dhe që lehtësojnë aksesin në burime financiare në sajë të bashkëpunimit institucional me sektorin privat.

STUDENTËT

Universiteti i Tiranës ka potencialin më të madh të të ardhmes së vendit tonë! Elita e arsimit parauniversitar i beson UT-së formimin profesional dhe jo vetëm. Detyra dhe përgjegjësia jonë e madhe është t'i përgjigjemi atyre me cilësi e standarde, jo vetëm në mësimdhënie e në shërbime administrative por në të gjitha aktivitetet dhe strukturat që mbështesin përfshirjen e tyre dhe zhvillojnë jetën akademike dhe studentore në UT. Gjatë këtij mandati do të kthej fokusin te studentët dhe interesat e tyre.

- ✓ **Fokusi në përmirësimin e standardeve të mësimdhënies** (duke nisur nga kurrikulat, programet e studimit, zhvillimin profesional të personelit akademik, kushteve të infrastrukturës etj.).
- ✓ **Funksionimi dhe zhvillimi i sistemit digjital & platformës studentore online:** Prioritet gjatë këtij mandati do të jetë digjitalizimi i shërbimeve që ofrohen për studentët e UT-së duke ulur kohën dhe kostot e nevojshme për marrjen e shërbimeve. Komunikimi student-pedagog do të zhvillohet në mënyrë të modernizuar edhe nëpërmjet kësaj platforme në të gjithë elementët mësimorë (materiale studimore online, teste online, vlerësim online, komunikim të vazhdueshëm). Nga pikëpamja administrative dokumentacionet e nevojshme (listë notash, vërtetim studenti, program mësimor, syllabuse) do të mund të gjenerohen online. Ky shërbim do të ofrohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze me synim uljen e kostove për studentët e UT-së, që sot shpenzojnë shuma jo të vogla për përkthim dhe noterizim të dokumentacioneve.
- ✓ **Rishikimi tarifave të studimit.** Në bashkëpunim me Rektoratin, Senatin Akademik, Dekanatet, Bordin e Administrimit dhe administratorin, do të iniciohet, brenda kuadrit ligjor që ofron LAL, rishikimi i tarifave të studimit të nivelit Bachelor dhe Master.
- ✓ **Mbështetja e studentëve ekselentë.** Do të mbështesim maksimalisht studentët me rezultate ekselente në fushat e tyre të studimit jo vetëm nëpërmjet përjashtimit



nga tarifat e studimit dhe bursave vjetore, por edhe nëpërmjet promovimit të tyre profesional si brenda strukturave të UT-së ashtu edhe jashtë tij.

- ✓ **Biblioteka Qendrore Universitare.** Brenda këtij mandati do të punohet për mundësimin e një biblioteke qendrore të universitetit dhe përmirësimin e kushteve dhe kapaciteteve të bibliotekave të fakulteteve.
- ✓ Rritja e investimeve për pajisje me literaturë shkencore në biblioteka. Ky shërbim do të ndihmojë studentët e UT-së për të gjetur me lehtësi literaturën e rekomanduar si dhe për të ulur kostot në blerjen e literaturës.
- ✓ **Fuqizimi i Qendrave të karrierës.** Gjatë këtij mandati në fokus të veçantë do të jenë fuqizimi dhe zhvillimi i Qendrave të Karrierës si në nivel institucional dhe në nivel fakulteti me burime njerëzore, financiare dhe hapësira të dedikuara për



t'iu përgjigjur më së miri nevojave specifike të studentëve në degë dhe programe të ndryshme studimi. Këto struktura do të mundësojnë:

1. **Këshillim karriere.** Studime të tregut të punës për të orientuar studentët në zgjedhjet e tyre.
2. **Pasurimin e jetës studentore me aktivitete Sociale, Kulturore, Sportive.** Qendrat e karrierës planifikojnë një kalendar vjetor me aktivitete, i cili më pas pasurohet me propozimet e studentëve dhe stafit përgjatë vitit akademik, si p.sh.: Kampionate Debati, Shkolla Verore / Dimërore, Panaire Karriere, takime të hapura, Bussines Trip, kampionate sportive, fushata sensibilizuese etj. Vend të veçantë do kenë edhe aktivitetet Sportive duke i rikthyer UT-së traditën e kampionateve në nivel fakulteti dhe institucional në disiplina të ndryshme sportive duke synuar gjithashtu një bashkëpunim të ngushtë edhe me institucione të tjera të arsimit të lartë në vend dhe më



gjerë. Talentet sportive brenda UT do të mbështeten për pjesëmarrje në aktivitete sportive ndërkombëtare duke përfaqësuar denjësisht sportin universitar të UT-së.

3. Krijimin e rrjetit të Studentëve Vullnetarë në nivel

fakulteti dhe universiteti. Studentët e këtij rrjeti do jenë pjesë e të gjithë aktivitetit dhe funksionit të Qendrave, duke i përfshirë ata që nga procesi i planifikimit e deri në realizimin e aktiviteteve. Një strukturë e tillë rrit frymën e bashkëpunimit mes studentëve, mes stafit dhe studentëve, krijojnë një urë lidhëse të drejtpërdrejtë për përçimin e problematikave dhe zërit të tyre pranë strukturave tona, por mbi të gjitha i jep studentëve një eksperiencë bashkëpunimi që zhvillon aftësitë ndërpersonale, aq shumë të rëndësishme në tregun e punës. Kjo strukturë kontribuon edhe në krijimin e një network-u për secilin prej tyre për të ardhmen.



- 4. Krijimin e Rrjetit të Alumnit.** Studentët pasi përfundojnë studimet nuk mund dhe nuk duhet të shkëpusin marrëdhëniet me fakultetin përkatës. Ata janë një aset i padiskutueshëm, të cilëve mund t'u ofrohet zhvillim i mëtejshëm akademik, profesional etj., por gjithashtu mund të kontribuojnë në zhvillimin tonë institucional nëpërmjet eksperiencave të tyre në tregun e punës.
- 5. Informimin dhe mbështetjen për aplikime në mobilitete studentore.** Kjo qendër do jetë përgjegjëse për informimin rreth mundësive si edhe asistimin për plotësimin e të gjithë dokumentacioneve të nevojshme për aplikim.

6. **Zhvillimin e trajnimeve, workshop-eve, leksioneve të hapura** me ekspertë të ftuar, etj. për zhvillimin e mëtejshëm profesional të studentëve.

7. **Praktika mësimore, internship-e.** Përgjatë viteve të studimit nëpërmjet bashkëpunimit me institucione, organizata apo kompani në tregun e punës, do të ofrohen mundësi praktikash mësimore, internship-esh etj.



8. **Punësim.** Ky është edhe misioni final i Qendrës së Karrierës: ndërmjetësimi i tregut akademik me tregun e punës. Qendra do të krijojë një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh në tregun e punës, ku do të referojë përgjatë gjithë kohës mundësi punësimi pranë këtyre subjekteve. Këto mundësi do t'u komunikohen studentëve dhe të sapo diplomuarve në UT në adresat e tyre të e-mailit dhe në çdo formë tjetër komunikimi me ta. Për herë të parë do të ndërtohet edhe “Portali i Punësimit” për studentët e Universitetit të Tiranës.

- ✓ ***Mbështetja ndaj studentëve dhe forumeve studentore.*** Fuqizimi i zërit të studentëve në të gjitha strukturat e përcaktuara në ligj në funksion të përmirësimit dhe angazhimit real të tyre do jetë prioritet gjatë këtij 4-vjeçari. Sa më shpejt, do të krijohen kushtet për organizimin e zgjedhjeve për këshillat studentorë dhe funksionimi i tyre në të gjitha njësitë kryesore të UT-së.
- ✓ ***Rritje e numrit të mobiliteteve studentore në universitete evropiane.*** Shkëmbimi i eksperiencave akademike, sociale dhe kulturore është një element mjaft i rëndësishëm i jetës akademike e studentore. Gjatë mandatit tim si rektor i UT-së do ketë një angazhim maksimal në rritjen e numrit të mobiliteteve studentore në kuadër të programeve Erasmus+ (KA1), por gjithashtu edhe në sajë të rritjes së bashkëpunimeve dypalëshe nëpërmjet marrëveshjeve të nënshkruara me institucione perëndimore të arsimit të lartë.



Erasmus+

- ✓ ***Krijimi i Klubit Studentor Erasmus+ në nivel institucional dhe fakulteti*** do shërbejë si një network studentor për të gjithë ata që kanë qenë pjesë e këtyre mobiliteteve.
- ✓ Do të inkurajohet ***“blended learning”*** përgjatë gjithë universitetit dhe në të gjitha programet studimore duke i prezantuar studentët me qasje bashkëkohore moderne të metodave të mësimdhënies, që synojnë formimin e tyre multidimensional dhe rritjen e aftësive për zgjidhjen e problemeve praktike të jetës reale.

VOTO **ARTAN HOXHA**
për t'i kthyer dinjëtin Universitetit të Tiranës